



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Smail Latifi , Kryetar i Komunës së Rahovecit Afrim Dina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Xhevat Tafa , U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL Date: 16/07/2019 Nr. 020-771
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi nr. 1972 për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510056-0034-0 në fshatin Opertushë
I miratuar më datë më datë: 28.06.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.07.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi nr. 1972 për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510056-0034-0 në fshatin Opertushë,	<p>Vendimi nr. 1972 për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510056-0034-0 në fshatin Opertushë, është në kundërshtim me Ligjit Nr. Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale.</p> <p>Vendimi është i kundërligjshëm, për shkak se komuna nuk ka të drejtë të bartë dhe regjistrojë pronën në Librin Kadastral pa u përfunduar e gjithë procedura për bartjen e pronës së paluajtshme.</p> <p>Për bartjen e pronës së paluajtshme duhet të përmbushen këto kritere të cilat janë të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale :</p> <ol style="list-style-type: none">1. Komuna duhet bëjë identifikimin dhe përshkrimin e saktë të pronës së paluajtshme të cilën kërkon t'i bartet në pronësi për realizimin e interesit publik.2. Komuna për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore kërkesën e parashtron pranë Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale.3. Ministria përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale, pas shqyrtimit dhe kompletimit të lëndës të pranuar nga komuna me rekomandim, e dërgon në Qeveri për miratim.4. Qeveria vendos për kërkesën e komunës.5. Në rast të aprovimit të kërkesës nga Qeveria, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, bëhet bartja e pronës te komuna. <p>Komuna e Rahovecit nuk e ka përmbushur asnjë nga këto kriteret e lartcekura.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Smajl Latifi, gradonačelnik opštine Orahovac Afrim Dina, predsedavajući Skupštine opštine Orahovac	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, <i>Adrijana Hodzic</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a <i>Begolli</i>	
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS <i>Xhevat Tafa</i>	Dana: 16.07.2019 Br. 020-771
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akta opštine Orahovac	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.1972 za proglašenje od opšteg interesa dela parcele P-71510056-0034-0 u selu Opertuša.

Usvojena dana: 28.06.2019. godine

Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 03.07.2019. godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka br.1972 za proglašenje od opšteg interesa dela parcele P-71510056-0034-0 u selu Opertuša.	<p>Odluka br.1972 za proglašenje od opšteg interesa dela parcele P-71510056-0034-0 u selu Opertuša je u suprotnosti sa Zakonom br.06/L-092 za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine.</p> <p>Odluke je protivzakonita zato što opština nema pravo na prenos i upis imovine na katastarskoj knjizi pre nego što se završi cela procedura za prenos nepokretne imovine.</p> <p>Za prenos nepokretne imovine treba ispuniti ove kriterijume koji su propisani članom 27 Zakona br.06/L-092 za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Opština mora utvrditi i tačno opisati nepokretnu imovinu koju zahteva da joj se prenosi u vlasništvo radi ostvarivanja javnog interesa.2. U cilju prenosa nepokretne imovine kojom upravlja centralna institucija, opština podnosi zahtev nadležnom Ministarstvu za lokalnu samoupravu.3. Ministarstvo nadležno za lokalnu samoupravu, nakon razmatranja i kompletiranja predmeta podnete od strane opštine, sa preporukom prosleđuje Vladi za odobrenje.4. Vlada odlučuje o zahtevu opštine.5. U slučaju odobrenja od strane Vlade, u roku od trideset (30) dana, vrši se prenos imovine na opštinu. <p>Opština Orahovac nije ispunila nijedan od gore navedenih kriterijuma</p>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave *traži* od Skupštine opštine/gradonačelnika opštine da preduzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana dostavljanja zahteva za ponovno razmatranje akta. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal – Skupština Opštine
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Municipal Council / Municipal Administration

-III- Nr. i prot. 1972 Më 28.06.2018
Br. prot. Dt.

Duke u bazuar në nenin 12 nenin 17 nenin 24 dhe nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/06/2006), paragrafi 1 pika 1, neni 40 paragrafi 2 pika 2.9 dhe neni 94, të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, propozimit të Kryetarit të Komunës me nr. protokollit 01/239/18 miratuar më 07.06.2018, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.06.2018 miratoi:


VENDIMI


Shpallet me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510056-00034-0 në fshatin Opterushë

1. Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës nr. 01/239/18i dt. 07.06.2018, dhe Shpallet Interes i Përgjithshëm publikë pjesa e parcelës kadastrale me Nr. P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë, në sipërfaqe prej 6000 m² (gjashtë mijë metra katrorë), nga sipërfaqëja e përgjithshme prej 127.346 m² (njëqind e njëzet e shtatë mijë e treqindë e katërdhjet e gjashtë metra katrorë).
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm në pjesën e parcelës P-71510056-00034-0 në sipërfaqe prej 6000 m² të cekur në pikën 1 të këtij propozimi është: Ruajtja, rregullimi dhe mirëmbajtja e vendit të rënies së dëshmorëve të kombit Xhehal Hajda – Toni, Selajdin Mullabazi – Mici, Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Ymeri në fshatin Opterushë, dhe gjendet në vendin e quajtur CER-NAD ZABELJOM, me kulturë kullosë e klasit të 6-të, në sipërfaqe të përgjithshme prej 127.346 m², e që konsiston të jetë pasuri Shtetërore e Kosovës, KK. Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve-Rahovec.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komfor dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerre të gjitha veprimet të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelimin, skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral në emër të Komunës së Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimit kujdeset Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 1972
Rahovec, 28.06.2018





**ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
RAHOVEC**



Me: 29.05.2018

Nr. prot. 066/18

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPËSTINA GRAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odsjetnje za Opštu Upravu

III- Nr. i prot. 587 ME DI 29.05.2018
Br. prot. RAHOVEC - GRAHOVAC

~~Ë dëdhjetë~~ Kryetari të Komunës së Rahovecit z. ~~Shiraj Isatifi~~
Drejtorisë për xheodezi, kadaster dhe pronë

Lënda: Kërkesë

Kerkojmë nga institucionet e lartpërmendura që të fillojnë procedurën në lidhje me inqizimin dhe identifikimin e pronave në vendërenjët e deshmorëve, ku janë të ngritur lapidaret.

Që mundësisht të shpallen me interes të veçantë të zonave të lartëcekura në nivel të komunës së Rahovecit.

Me respekt OVL e UÇK-së dega Rahovec.

Punuar në dy kopje:

1x1. Kryetari të Komunës së Rahovecit dhe
Drejtorisë për xheodezi, kadaster dhe
pronë

1x1. Arkivët të OVL UÇK-së dega Rahovec.

Kryetari i OVL-UÇK- së dega Rahovec

Vajdin Berisha
VAJDIN BERISHA





A.2.1.1.1.1 I SHRYTËZIMIT / VRSTA KORISÇENIA / TYPE OF USE

Numri Breg Number	Lloji i shrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shkrytëzimi aktual i parcelës Trenimio korisçenja parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i Klases Kualiteti i Klases Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Përfaqja (m ²) Area
1	Bujqësore/Peljoqim/vendbanim/grahehure	Kullban/Pashajq/pasture	Kullban E Klases së parë/ok 6 Klasesh Class Pasture	127346

B. PRONARË/POSEDUESI - VLASNIK/DRËZALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Imer Name	Nr. personi Lesh i merj ID. No.	Vendbanimi Prehivodiste Resident	Kodi postar Postarakt kod Postal code	Hafesite e adresës Foliedhvori adresa Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurime Azurimno Updated
Personat individual / Individualna Drazvina / single possessor	PASURI SHITËTE KOSOV/K.K.RAHOVËC SHFRY.EK.E.PY. RAHOVËC.	ECHD151992	RAHOVËC / ORAHOVAC / BAHOVAC /		NEBANJERS 6	1/1		





Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministërstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Smajl Lutfi, Kryetar i Komunës së Rahovecit Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit.	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Da e: 02/07/2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Aktit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit	Nr.020-754
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrit të përkohshëm të punëve të brendshme dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Pushtat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Veprimet Lokale aktet e kuvendit të komunës në vijim:

- Vendim Nr. 1971 për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm të parcelës Nr. P-7151005-00524-4;
- Vendim Nr. 1972 për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm të parcelës Nr. P-71510056-00034-0 në Bishan Opertushë;
- Vendim Nr. 1973 për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në teren për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Rahovecit;
- Vendim Nr. 1975 për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm të parcelës Nr. P-71510057-02240-1.

Të miratuarat me datë: 28.06.2018
Të parashtruarat për shqyrtim në MAPL me datë: 29.06.2018
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se aktet e komunës janë në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi dhe si të tilla mund të prodhojnë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqartimi të nevojshëm në lidhje me këto vlerësime.